

## KONTRATË E PUNËMARRËSIT PËR ANËTARËSIM NË NJË PLAN PENSIONI PROFESIONAL TË KRIJUAR NGA PUNËDHËNËSI NË FONDIN E PENSIONIT PRIVAT

### TË DHËNAT E ANËTARIT TË FONDIT

Emër Atësia Mbiemër \_\_\_\_\_, Shtetësia \_\_\_\_\_  
Nr. Personal \_\_\_\_\_ (kopja e të cilës i bashkëlidhet kontratës)  
Data e lëshimit \_\_\_\_\_, Data e skadimit \_\_\_\_\_, Shteti ku paguan taksat \_\_\_\_\_  
Datëlindja \_\_\_\_\_, Vendlindja: \_\_\_\_\_, Adresa \_\_\_\_\_  
Adresa korrespondente \_\_\_\_\_  
Kodi Postar: \_\_\_\_\_, Tel./Mob.: \_\_\_\_\_, E-mail: \_\_\_\_\_  
Nr. i Pasaportës për shtetasit e huaj \_\_\_\_\_ (kopja e të cilës i bashkëlidhet kontratës)  
Nr. i lejes së qëndrimit në Shqipëri \_\_\_\_\_ (kopja e të cilës i bashkëlidhet kontratës)  
Shuma e kontributit mujor \_\_\_\_\_, Frekuenca e pagesës \_\_\_\_\_  
Pozicioni i punës: \_\_\_\_\_  
Burimi i të ardhurave \_\_\_\_\_

Nën cilësinë e Anëtarit të Fondit të Pensionit Profesional, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë ligjore se jam informuar, kam kuptuar dhe jam dakord me përmbajtjen e kushteve të kontratës, PROSPEKTIN, si dhe tarifën e aplikuar nga "Credins Invest" sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve.

### TË DHËNAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

"Credins Invest" sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve, është regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, nr. 34260, datë 31/10/2005, licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin nr. 156, datë 23/11/2011, me Vendimin nr. 85, datë 30/05/2016, si dhe me Vendimin nr. 207, datë 29.12.2020, me seli në adresën: Rruga "Nikolla Tupe", Nr. 1, Kati 3, Tiranë, përfaqësuar nga Znj. Estela Koçi, Administratore e Përgjithshme.

### TË DHËNAT E SHOQËRISË PUNËDHËNËSE

Shoqëria PUNËDHËNËSE me emërtimin "\_\_\_\_\_", është shoqëri e regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, me NIPT \_\_\_\_\_, me seli në adresën: Rr. "\_\_\_\_\_" përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm Z./Znj. \_\_\_\_\_, Shtetësi \_\_\_\_\_ Nr. i dokumentit të identifikimi \_\_\_\_\_ (kopja e të cilës i bashkëlidhet kontratës)  
Data e lëshimit \_\_\_\_\_, Data e skadimit \_\_\_\_\_, Shteti ku paguan taksat \_\_\_\_\_, Datëlindja \_\_\_\_\_, Vendlindja: \_\_\_\_\_, Tel./Mob.: \_\_\_\_\_, E-mail: \_\_\_\_\_ Adresa: \_\_\_\_\_  
Nr. i Pasaportës për shtetasit e huaj \_\_\_\_\_ (kopja e të cilës i bashkëlidhet kontratës)  
Nr. i lejes së qëndrimit në Shqipëri \_\_\_\_\_ (kopja e të cilës i bashkëlidhet kontratës)  
Shuma e kontributit mujor \_\_\_\_\_, Frekuenca e pagesës \_\_\_\_\_  
Burimi i të ardhurave \_\_\_\_\_

Nën cilësinë e kontributorit, për punëmarrësit, anëtarë të Fondit të Pensionit "Credins Pension", deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë ligjore se jam informuar, kam kuptuar dhe jam dakord me përmbajtjen e kushteve të kontratës, PROSPEKTIN, si dhe tarifën e aplikuar nga shoqëria "Credins Invest" sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve.

Data e lidhjes së kontratës: \_\_\_\_\_ Vendi: \_\_\_\_\_

#### "CREDINS INVEST"

sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve. Përfaqësuar nga:

**Anëtar**  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

**Estela Koçi**  
Administratore e Përgjithshme

**Shoqëria PUNËDHËNËSE**  
përfaqësuar nga  
Administrator i Përgjithshëm

**Armira Çitozi**  
Zv. Administratore e Përgjithshme

## NENI 1 OBJEKTI

- Objekt i kësaj kontrate është të rregullojë marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet Anëtarit të Fondit të Pensionit dhe "CREDINS INVEST" sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve (këtu e në vijim "Shoqëria Administruese")
- Marrëdhëniet kontraktuale të dyanshme, të përmendura në pikën 1, rrjedhin nga anëtarësimi në Fondin e Pensionit Privat "Credins Pension" (këtu e në vijim "Fondi"), me qëllim investimin e aseteve dhe ofrimin e përfitimeve për pensione në të ardhmen, në masën e zotërimit të kuotave.

## NENI 2 SUBJEKTET E KONTRATËS

- Subjektet e kësaj kontrate janë individit, i cili gëzon zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, shtetas shqiptar apo i huaj, i cili me pëlqimin e vet bëhet anëtar i Fondit, si dhe Shoqëria Administruese, e cila në respektim të kontratës dhe të legjislacionit në fuqi ofron shërbimet e fondit të pensionit privat.
- Shërbimet e fondit të pensionit privat, në kuptim të kësaj kontrate, janë ato shërbime të miratuara në planin e pensionit profesional, nëpërmjet kontratës së lidhur për këtë qëllim midis punëdhënësit dhe shoqërisë administruese për të ofruar ndaj individëve punëmarrësve përfitime për pension, sipas planit të pensionit profesional.

## NENI 3 BAZA LIGJORE

Kjo kontratë hartohet në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, si Kodin Civil, ligjin nr.76/2023, datë 21.09.2023 "Për Fondet e Pensionit Privat", me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe rregulloret e brendshme të Shoqërisë Administruese.

## NENI 4 PËRKUFIZIME

Termet e përdorur në këtë Kontratë kanë kuptimin e dhënë në ligjin nr.76/2023, datë 21.09.2023, dhe në prospektin bashkëlidhur kësaj kontrate.

## NENI 5 ANËTARËSIMI NË FOND

- Mund të anëtarësohet në këtë Fond çdo punëmarrës, i cili me pëlqimin e tij bëhet anëtar i fondit të pensionit dhe lidh këtë kontratë anëtarësimi me Shoqërinë Administruese për të përfutur shërbimet e fondit të pensionit.
- Është pjesë përbërëse e kësaj kontrate formulari standart i aplikimit, i cili për mban deklaratën personale të anëtarit. Duke e nënshkruar këtë deklaratë anëtar pranon kushtet e kontratës, si dhe deklaron nën përgjegjësinë e tij se është njohur dhe ka kuptuar plotësisht prospektin e Shoqërisë Administruese.
- Për çdo anëtar të Fondit i cili ka nënshkruar këtë kontratë, Shoqëria Administruese do të hapë një llogari personale.

## NENI 6 PAGESA E KONTRIBUTEVE

- Kontributet e anëtarit në këtë fond pensioni, do të jenë aset i tij në fond dhe do të përbëhen, vetëm nga kontribute në para.
- Në zbatim të dispozitave ligjore dhe të kësaj kontrate, asetet e Anëtarit në këtë Fond përbëhen nga kontributet në para, të bëra në emër dhe për llogari të Anëtarit, si dhe kthimi i investimit të bërë me këto kontribute, pas zbatimit të zbritjeve të nevojshme.
- Për efekt të kësaj kontrate dhe këtij neni, çdo kontribut i paguar nga Punëdhënësi në favor të Punëmarrësit, do të vlerësohet sikur është paguar nga vetë Punëmarrësi.
- Shoqëria Administruese, konverton në kuotë pensioni, sipas çmimit të kuotës një ditë përpara pagesës së kontributit, kontributet e investuara në Fond dhe asetet e transferuara nga një fond tjetër. Çdo kuotë pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie në asetet neto të Fondit. Vlera totale e kuotave në Fond është gjithmonë e barabartë me vlerën totale neto të aseteve të Fondit.
- Procedura e konvertimit të kontributeve të paguara nga Anëtarit në kuota përcaktohet në prospektin e Shoqërisë Administruese, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate. Rregullat për përlogaritjen e kuotave në përpjesëtim me shumën në llogarinë e anëtarëve të fondit të pensionit dhe për konvertimin e kuotave në para për pagesën e parave anëtarëve të fondit të pensionit, janë parashikuar në prospekt.
- Nëse Anëtarit përkohësisht apo përgjithmonë ndërpret pagesën e kontributeve, ai mbetet anëtar në Fond, dhe ka të njëjtat të drejta, si anëtarët e tjerë të Fondit.
- Anëtarit në këtë Fond, mund të për fundojë, të zvogëlojë ose të rrisë kontributet në çdo kohë dhe këto ndryshime, në asnjë mënyrë, nuk duhet të ndikojnë në shumën e kredituar në llogarinë e tij, pavarësisht nëse kjo shumë është krijuar nga kontributet e bëra nga punëdhënësi apo nga punëmarrësi.
- Punëdhënësi është përgjegjës ndaj punëmarrësve të vet për mospagimin e ndonjë kontributi të parashikuar. Shuma e përgjegjësisë varet nga shuma e kontributeve, që nuk janë paguar ose nuk janë paguar plotësisht në fondin e pensionit, nga të ardhurat nga investimet, të parashikuara për periudhë në fjalë dhe nga çdo kosto, që mund të ketë punëmarrësi për të detyruar punëdhënësin të respektojë detyrimin e tij për të paguar kontributin.

## NENI 7 POLITIKA E INVESTIMIT

- Investimi i aseteve të Fondit synon optimizimin e kthimit nga investimi duke minimizuar riskun, me qëllimin për t'u siguruar anëtarëve të Fondit të ardhura më të larta dhe të sigurta në moshën e pensionit.

- Karakteristikat e Fondit dhe të politikës së investimeve janë paraqitur në prospektin e bashkëlidhur kësaj kontrate.

Klasa e aseteve	Objektivi
Bono thesari dhe obligacione të emetuara dhe të garantuara nga Qeveria e RSH	99%
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	1 %
Bono thesari dhe obligacione të shteteve anëtare të BE të denominuara në monedhë EUR	0%
Depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë	0%

- Shoqëria Administruese do të synojë të respektojë objektivin e përcaktuar më poshtë për alokimin strategjik të aseteve

- Anëtarit pasi bie dakord me këtë kontratë dhe prospektin, merr përsipër riskun e investimit të Fondit.

## NENI 8 DEPOZITARI

- Shoqëria Administruese ka lidhur një marrëveshje për shërbimin e Depozitarit me Banka e Tiranës sh.a. me seli në adresën: Rruga: "Ibrahim Rugova", e licensuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbimet e kujdestarisë, depozitimit dhe të besimit me Vendimin nr. 23 datë 24.03.2010 si dhe e licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për fondet e pensionit me Vendimin nr. 2, datë 18.11.2010.

- Depozitari në këtë kontratë, nënkupton bankën e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit. Depozitari gëzon cilësinë e entitetit tërësisht të pavarur nga Shoqëria Administruese dhe çdo palë tjetër të lidhur me të.. Depozitari siguron që të gjitha të ardhurat e fondit të pensionit do të shpërndahen në përputhje me Ligjin dhe kontratën.

- Depozitari do të jetë përgjegjës për ruajtjen e Aseteve të fondit të pensionit dhe të aseteve të anëtarëve në Fond.

- Depozitari kontrollon administrimin e aseteve të Fondit nga Shoqëria Administruese, në përputhje me dispozitat e kontratës, prospektit, si dhe të legjislacionit në fuqi.

- Depozitari siguron që në transaksionet që përfshijnë asetet e fondit të pensionit, t'i kthehet fondit të pensioneve çdo përfitim brenda afateve kohore të përcaktuara.

## NENI 9 MBROJTJA E ASETEVE TË FONDIT TË PENSIONIT

Asetet e fondit të pensionit, të depozituara në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, nuk mund t'u nënshtrohen ekzekutimeve për detyrimet që depozitari ka ndaj të tretëve. Asetet e fondit të pensionit duhet të veçohen nga asetet e depozitarit, në bazë të së drejtës së veçimit në procedurë falimentimi dhe nuk përfshihen në shlyerjen e detyrimeve të kreditorëve të depozitarit.

## NENI 10 TË DREJTAT DHE DËTYRIMET E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

- Shoqëria Administruese në kuadër të kësaj kontrate ka detyrën kontraktuale:

- Të administrojë me efektivitet asetet e anëtarëve në fond, nëpërmjet diversifikimit investimeve, me synim rritjen e aseteve të anëtarëve.
- Të ofrojë pensione dhe përfitime të tjera (këtu nënkuptohen përfitimet e parashikuara në nenin 73 pika 2 dhe neni 74 i ligjit nr. 76/2023, date 21.09.2023), tek anëtarët, sipas kushteve dhe procedurave ligjore.
- Të informojë çdo anëtar lidhur me prospektin e Shoqërisë Administruese përpara se të nënshkruajë kontratën.
- Të pajisë anëtarët me kredencialet – Përdorues/Fjalëkalim për të aksesuar llogarinë e tyre në fondin e pensionit privat.
- Të njoftojë dhe informojë anëtarët nëpërmjet mjeteve elektronike.
- Të informojë anëtarët të paktën çdo 30 ditë, për asetet, përfshirë vlerësimin e vlerës neto të aseteve të Anëtarit në Fond, datat e kontributeve dhe transferimet e aseteve të bëra nga ose në emër të Anëtarit gjatë periudhës përkatëse dhe shndërrimin e këtyre kontributeve në kuota pensioni. Shoqëria administruese është përgjegjëse për saktësinë e llogaritjes së vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit.
- Të respektojë konfidencialitetin e llogarisë individuale të çdo anëtari dhe të japë informacion mbi asetet vetëm tek Anëtarët e Fondit, personat e autorizuar nga Anëtarit, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga Ligji.
- Të informojë në çdo kohë Anëtarët për sa i përket ndryshimeve në politikën e investimit, si dhe rregulloret përkatëse që krijojnë efekte për Anëtarët.
- Të kryejë transferimin e aseteve, mbështetur në kërkesën me shkrim të Anëtarit si në rastin e transferimit në një Fond tjetër të menaxhuar nga e njëjta Shoqëri Administruese, ashtu edhe në rastin e transferimit në një Fond të menaxhuar nga një tjetër Shoqëri Administruese.
- Të kryejë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e tij ose pagesat periodike në formë pensioni që i përgjigjen kësaj vlere, mbështetur në kërkesën me shkrim të Anëtarit, sipas kontratës.

## **NENI 11 GARANCITË**

1. Shoqëria administruese, që do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe:
  - a) Asetet e fondit të pensionit nuk do mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve, të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të shoqërisë administruese.
  - b) Fondi i pensionit nuk mund të jetë pjesë e procedurës së falimentimit.

## **NENI 12 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT**

1. Anëtari i fondit të pensionit, sipas kësaj kontrate, ka të drejtat e detyrimit e mëposhtme:
  - a) Të ketë pronësinë e aseteve të investuara në Fond;
    - I. Periudha përpara se Anëtari t'i njihet e drejta e përfitimit të kontributeve të paguara nga Punëdhënësi, në kuadër të kësaj kontrate do të jetë jo më e gjatë se dy vjet.
    - II. Nëse Anëtari (Punëmarrës sipas kësaj kontrate), ndërpret marrëdhënien e punës, ai mund të mbetet anëtar në fondin e pensionit. Nëse punëmarrësi vendos të mbetet anëtar, në kohën kur ndërpret marrëdhënien e punës, ai duhet të lidhë një kontratë të fondit të pensionit me Shoqërinë Administruese, e cila do të zëvendësojë kontratën e fondit, që kishte punëmarrësi gjatë kohës që ka qenë i punësuar. Shoqëria Administruese, e cila administron fondin e pensionit, nuk mund të refuzojë lidhjen e kontratës së fondit të pensionit me të njëjtat kushte, si kontrata e mëparshme e planit të pensionit profesional me punëmarrësin.
  - b) Të përfitojë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve ose pagesat periodike në formë pensioni sipas kushteve dhe procedurave ligjore;
  - c) Të informohet në periudha të rregullta kohore, mbi vlerën neto të aseteve në llogarinë e tij të pensionit;
  - d) Të përcaktojë shumën e kontributeve që do të paguajë, të ndryshojë këtë shumë, si dhe dinamikën e pagesës së kontributeve, sipas zgjedhjes së tij;
  - e) Anëtari mund të për fundojë, të zvogëlojë ose të rrisë kontributet në çdo kohë dhe këto ndryshime, në asnjë mënyrë, nuk duhet të ndikojnë në shumën e kredituar në llogarinë e tij, pavarësisht nëse kjo shumë është krijuar nga kontributet e bëra nga punëdhënësi apo nga punëmarrësi;
  - e) Të ketë një fond pensioni të trashëgueshëm.
2. Anëtari ka të drejtë që në çdo kohë dhe me kërkesën e tij të transferojë asetet e veta në një fond pensioni tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një tjetër shoqëri administruese me të cilën punëdhënësi ka një marrëveshje të ngjashme.
3. Anëtari që ka vendosur të transferojë asetet e veta në një fond të ri pensioni, duhet të njoftojë shoqërinë administruese të fondit të mëparshëm të pensionit, se kontrata me këtë shoqëri administruese do të për fundojë dhe se asetet e tij, duhet të transferohen në fondin e ri të pensionit, në kohën e caktuar, siç është rënë dakord.
4. Në rastin e transferimit të aktiveve të anëtarit në një shoqëri tjetër administruese, shoqëria administruese me marrjen e kërkesës me shkrim nga anëtari për të transferuar aktivet njofton brenda 5 ditëve pune shoqërinë tjetër administruese për kërkesën e anëtarit për transferimin e aktiveve.
5. Shoqëria administruese ekzekuton transferimin e aktiveve në llogari brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së konfirmimit të shoqërisë administruese tjetër, sipas pikës 2 të këtij neni.
6. Në rastin e transferimit brenda të njëjtës shoqëri administruese, transferimi ekzekutohet brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës nga anëtari.

## **NENI 13 PAGESA E PËRFITIMEVE**

1. Anëtari i fondit të pensionit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e tij ose pagesat periodike, në formë pensioni, që i përgjigjen kësaj vlere:
  - a) kur mbush moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm, që zbatohet për atë anëtar;
  - b) 5 vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit, të parashikuar me ligj për sistemin e detyrueshëm, që zbatohet për atë Anëtar;
  - c) kur bëhet i paaftë për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Pagesa e menjëhershme e vlerës neto të aseteve, do të kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të Anëtarit, në llogarinë e tij, jo më vonë se 15 ditë nga marrja e kërkesës.
3. Pagesat periodike në formë pensioni do të kryhen mbështetur në një marrëveshje të veçantë që do të lidhet midis Anëtarit dhe Shoqërisë Administruese, kur Anëtari plotëson kushtet e parashikuara nga Ligji për të përfituar.
4. Me qëllim përfitimit e pagesës së të gjithë aseteve të veta në fond. Anëtari i paraqet një kërkesë me shkrim Shoqërisë Administruese, shoqëruar me të gjithë dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve për të bërë tërheqjen, i cili përcaktohet në rregulloren e miratuar nga Shoqëria Administruese.
5. Komisionet bankare që shoqërojnë pagesat në llogarinë e anëtarit do të paguhen nga vetë anëtari.

## **NENI 14 TËRHEQJA E PARAKOHSHME**

1. Anëtari i Fondit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë që të tërheqë asetet nga llogaria individuale e Fondit të pensionit, përpara vërtetimit/plotësimit të kushteve të parashikuara në nenin 13 të kontratës. Shoqëria Administruese kryen pagesën e vlerës neto të aseteve në llogarinë e Anëtarit, brenda 15 ditësh nga marrja e kërkesës së Anëtarit për tërheqje të parakohshme.
2. Në rastin e tërheqjes së parakohshme Shoqëria Administruese, do të aplikojë penalitete, të cilat do të llogariten në raport me kohën e përmbushur nga anëtari nga çasti i kontributit të tij të parë, si dhe mbi vlerën neto të aseteve, dhe më konkretisht:
  - a) 2% për çdo tërheqje të parakohshme të kryer deri pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë.
  - b) 5% për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20 -të;
  - c) 10% për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10 -të;
  - d) 15%, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të;
3. Në rastin e vdekjes së Anëtarit të Fondit nuk aplikohet penalteti i tërheqjes së parakohshme.

## **NENI 15 PAGESA E ASETEVE NË RASTIN E VDEKJES SË ANËTARIT**

Në rastin kur Anëtari vdes përpara se të marrë pagesën e të gjithë aseteve të veta, asetet në llogarinë e tij/saj u shpërndahen trashëgimtarëve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, që rregullojnë trashëgiminë.

## **NENI 16 TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUERE**

Shoqëria Administruese në emër dhe për llogari të këtij fondi do të aplikojë tarifën e mëposhtme:

- a) Tarifa e administrimit të Fondit do të jetë 2 % në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit. Vlera neto e aseteve përbëhet nga vlera e përgjithshme e aseteve e zvogëluar nga zbritja e detyrimeve dhe tarifave deri në datën e vlerësimit.
- b) Tarifa e administrimit të Fondit do t'i ngarkohet aseteve të Fondit në fund të çdo dite, dhe do të mbahet në fund të çdo muaji, si shumë e vlerës ditore për atë muaj.
- c) Në rastin e transferimit të aseteve me kërkesën e Anëtarit të fondit në një Fond tjetër, të menaxhuar nga një shoqëri tjetër administruese, tarifa që do të aplikohet do të jetë 0,5 % e shumës së transferuar.
- d) Çdo ndryshim i tarifave që do të aplikohen nga Shoqëria Administruese, do t'u njoftohet Anëtarëve të Fondit, të paktën 12 muaj përpara.

## **NENI 17 TRAJTIMI FISKAL I PËRFITIMEVE TË MARRA NGA ANËTARI**

Çdo pagesë e marrë nga anëtari i fondit të pensionit, tatohet me tatimin mbi të ardhurat personale.

## **NENI 18 KOHËZGJATJA E KONTRATËS**

1. Kjo kontratë lidhet për një afat të pacaktuar, dhe do të sjellë pasojë ligjore vetëm pasi, të jetë kryer pagesa e parë e kontributit, sipas metodës së rënë dakord mes palëve.
2. Kontrata e fondit të pensionit do të përfundojë:
  - a) Në rastin kur të gjitha asetet e Anëtarit të fondit janë transferuar në një tjetër Fond Pensioni;
  - b) Në rastin e tërheqjes së parakohshme të Anëtarit të Fondit;
  - c) Në rastin e vdekjes së Anëtarit të Fondit.

## **NENI 19 GJYKATA KOMPETENTE**

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet mirëkuptimi mes palëve, ato gëzojnë të drejtën t'i adresohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

## **NENI 20 DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

1. Në të gjitha rastet që kërkohet nga ligji, ndryshimet dhe shtesat në kontratë do të mar rin miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Ndryshimet dhe shtesat në kontratë do të bëhen me mirëkuptimin e palëve, nënshkruese të saj.
2. Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe në dy kopje identike, nga një për secilën palë nënshkruese.
3. Për sa më sipër Autorizoj Shoqërinë administruese "Credins Invest", për përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me ligjin nr. 9887, date 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Me përpunim të dhënash në kontekstin e këtij autorizimi bazuar në Ligjin Nr.9887, do të kuptojmë "grumbullimin, regjistrimin, ruajtjen, renditjen, përshtatjen, ndreqjen, këshillimin, shfrytëzimin, përdorimin, bllokimin, fshirjen ose shkatërrimin, transmetimin" etj.
4. Autorizoj Shoqërinë administruese "Credins Invest", për deklarimin e të dhënave të mia personale, pranë institucioneve përkatëse të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

## DEKLARATAT E ANËTARIT

Nën cilësinë e Anëtarit/Kontributorit të Fondit të Pensionit "Credins Pension":

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë ligjore se jam informuar, kam marrë në dorëzim, kam lexuar dhe kuptuar, si dhe jam dakord me përmbajtjen e kushteve të kontratës, Prospektin, si dhe tarifën e aplikuar nga Credins Invest sh.a. - Shoqëri Administruese e Fondeve.

Deklaroj se kam kuptuar që ky është investimi i duhur dhe jam informuar hollësisht për risqet, që lidhen me investimin në fondin e pensionit dhe se risku i agjencisë, risku i kredisë, risku i tregut dhe çdo risk tjetër, që shoqëron investimin në fondin e pensionit privat "Credins Pension". Deklaroj se kam kuptuar profilin tim të riskut dhe marr përsipër rreziqet e përfshira.

Deklaroj nën përgjegjësinë time se investimi i kontributeve, do të shërbejë vetëm për qëllime të ligjshme dhe njëkohësisht burimi i tyre është nga një aktivitet i ligjshëm.

Deklaroj se informacioni i dhënë nga ana ime në këtë kontratë është i vërtetë dhe i saktë. Është detyrimi im të përditësoj këto të dhëna, sa herë që do të ndryshohen nëpërmjet aksesit online apo një kërkesë me shkrim drejtuar shoqërisë administruese.

## PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Deklaroj se jam në dijeni se të dhënat e mia personale të deklaruara në këtë kontratë si dhe/ose në çdo dokument tjetër (formular/pyetësor/deklaratë dhe jo vetëm) të nënshkruar apo deklaruar pranë Credins Invest do të përpunohen nga kjo e fundit me standardet me të larta të sigurisë në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 9887 datë, 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Unë shpreh pëlqimin tim që Credins Invest sha, të mbledhë të dhënat e mia personale të deklaruara nga ana ime, si edhe t'i përpunojë më tej ato vetëm për qëllimin e ofrimit të shërbimit për të cilin po aplikoj. Gjithashtu, deklaroj dhe jap miratimin tim për procesimin e mëtejshëm të të dhënave personale nga ana e Credins Invest sha, duke i transferuar këto të dhëna drejt palëve kontraktore të cilat mund të jenë në cilësinë e përpunuesit në kuadër, të çeljes, mirëmbajtjes dhe administrimit të llogarisë. Në këtë kuadër, jam njohur me faktin që të dhënat e mia personale i transferohen Depozitarit të Fondit të Pensionit, bazuar në Ligjin nr 76/2023, "Për Fondet e Pensionit Privat", subjektit Credins Bank Sha, Shqipëri, në mënyrë që shoqëria të ushtrojë vigjilencën e duhur si edhe të zbatojë detyrimet e tjera që burojnë nga legjislacioni në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave. Autorizoj në mënyrë të shprehur Credins Invest sha, që të ruajë të dhënat e mia personale për një afat deri në 5 vite pas mbylljes së marrëdhënies së biznesit mes meje dhe shoqërisë. Gjithashtu, jam informuar se bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, unë mund të ushtroj në çdo kohë të drejtën për akses, të drejtën për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale që përpunohen nga ana e Credins Invest sha. Gjithashtu në çdo kohë ruaj të drejtën për t'u ankuar tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale" dhe ruaj të drejtën për t'u tërhequr nga dhënia e pëlqimit për përpunim e të dhënave.

## Miratimi për përpunimin e të dhënave personale në rast ofertash promovionale.

Jap miratimin tim të pakushtëzuar që Credins Invest sh.a., të përdorë të dhënat e mia personale për qëllimin e përfitimit nga ana ime të ofertave promovionale, si pjesë e paketës së produkteve/shërbimeve që Shoqëria ofron (apo do të ofrojë në të ardhmen), nëpërmjet një ose disa prej kanaleve të informimit, duke përfshirë por pa u kufizuar në: i) postë zyrtare ii) sms iii) telefonatë iv) postë elektronike etj. Në këtë kuadër autorizoj Credins Invest sh.a., që duke respektuar standardet me të larta të sigurisë, si dhe bazuar në dispozitat ligjore dhe rregullative në fuqi, të delegojë përpunimin e mëtejshëm të të dhënave të mia personale, duke i transferuar këto të dhëna tek palë të treta të specializuara për këtë qëllim. Gjithashtu, deklaroj se jam njohur me të drejtën që në çdo kohë të kërkoj nga Shoqëria revokimin e këtij miratimi.

Unë pranoj

Unë nuk pranoj

**Anëtari** (Emër, Mbiemër, Firmë)

**Shoqëria Administruese Credins Invest sh.a.**  
përfaqësuar nga